

UDHËZIM
Nr. 21, datë 9.12.2022

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 1, DATË 11.2.2022,
“PËR KRITERET, PROCEDURAT DHE MËNYRËN E ADMINISTRIMIT TË
FONDIT TË PROGRAMIT PËR BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN RURAL”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë”; të pikës 3, të nenit 6 dhe të nenit 36, të ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007, “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, të nenit 18, të ligjit nr. 64/2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar; dhe të ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të pikës 5, të VKM-së nr. 101, datë 9.2.2022, “Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural për vitin 2022”, ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe ministri i Financave dhe Ekonomisë

UDHËZOJNË:

Në udhëzimin nr. 1, datë 11.2.2022, “Për kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit për programin e bujqësisë dhe zhvillimit rural”, të ndryshuar, bëhen shtesa dhe ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Në kreun VII, “Procedurat që do të ndiqet për përzgjedhjen, verifikimin dhe pagesat për masat mbështetëse me nr. 1, 3–7/1”, bëhen shtesat si vijon:

a) Pas pikës 4 shtohet pika 4/1 me këtë përmbajtje:

“Për masën 7/1, të gjithë aplikantët duhet të dorëzojnë dokumentacionin e pronësisë së tokës ose përdorimit të saj, brenda datës 16.12.2022.”.

b) Pas pikës 12, shtohet pika 12/1, me këtë përmbajtje:

“Për verifikimet në terren të numrit faktik të tufës bazë dhe zgjojeve, për masat mbështetëse nr. 6 dhe 7, angazhohen edhe veterinerët zyrtarë të Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.”.

2. Në kreun X, “Kriteret, dokumentacioni dhe procedura për masën 13: mbështetje me naftë për kryerjen e punimeve të mekanizuara në bujqësi”, në pikën 7 bëhet ndryshimi, si vijon:

“Togfjalëshi ‘15 dhjetor 2022’ zëvendësohet me togfjalëshin ‘31 dhjetor 2022’”.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca

MINISTËR I FINANCave DHE EKONOMISË
Delina Ibrahimaj